



KUVENDI KOMUNAL - KLINË

**RREGULLORJA
PËR
PËRDORIMIN E GJUHËVE NË INSTITUCIONET KOMUNALE**

Klinë, prill 2007

Në mbështetje të dispozitës së nenit 35 të Ligjit nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve të miratuar nga Kuvendi i Kosovës në korrik të vitit 2006, i nënshkruar dhe shpallur nga PSSP në Rreg. nr. 2006/51 të dt. 20 tetor 2006, pastaj në bazë të nenit 3 dhe 4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/45 për Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, Kuvendi komunal në Komunën e Klinës në seancën e vetë të rregullt të IV-të më radhë për vitin 2007, të mbajtur më dt. 27.prill 2007, nxori dhe miratoi:

**RREGULLORE
PËR
PËRDORIMIN E GJUHËVE NË INSTITUCIONET KOMUNALE**

I.-DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Më këtë rregullore dhe në pajtim më Ligjin për Përdorimin e gjuhëve, rregullohen kushtet e përdorimit të barabartë të gjuhëve dhe shkrimeve si dhe sigurohet zbatimi i barabartë i tyre në institucionet komunale të Komunës së Klinës.

Përkufizimet dhe qëllimi

Neni 2

Përkufizimet dhe nocionet përkatëse të çështjes së gjuhëve dhe qëllimi i rregullores dalin nga vetë pjesa e parë e ligjit Dispozitat e përgjithshme (dispozita e nenit 1 të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve).

II.-KUSHTET PËR PËRDORIMIN E BARABARTË TË GJUHËVE

Neni 3

Kushtet për përdorimin e barabartë të gjuhëve në institucionet e Kosovës si dhe në komuna janë të përcaktuara në dispozitën e nenit 2 dhe 3 të Ligjit për Përdorimin e gjuhëve.

Përdorimi i gjuhës në institucionet e komunës

Neni 4

Në të gjitha institucionet komunale zbatohet barazia e gjuhëve zyrtare. Gjuhë zyrtare në Komunën e Klinës është gjuha shqipe dhe serbe.

Neni 5

Çdo person apo palë procedurale ka të drejtë të komunikoj dhe të pranoj shërbimet përkatëse dhe dokumentet publike nga institucionet komunale dhe nga zyrtaret në cilëndo gjuhë zyrtare.

Çdo organ përfaqësues dhe ekzekutiv komunal ka për detyrë të siguroj se çdo person mund të komunikojë dhe të pranojë shërbimet në dispozicion dhe dokumentet publike nga çdo institucion dhe organ komunal në cilëndo gjuhë zyrtare.

Institucionet komunale do të mundësojnë përkthimin nga një gjuhë zyrtare në tjetrën, nëse kjo kërkohet, në takimet e këtyre organeve përfaqësuese dhe ekzekutive komunale, po ashtu edhe në takimet publike të organizuara nga komuna.

Gjuhët zyrtare përdorën në baza të barabarta në takimet dhe në punën e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive komunale.

Neni 6

Shënimet e takimeve dhe shënimet tjera zyrtare të organeve komunale, regjistrat publikë dhe dokumentet tjera zyrtare mbahen dhe lëshohen në gjuhët zyrtare të komunës në kuptim të dispozitës së nenit 7 pika 7.4 të Ligjit për Përdorimin e gjuhëve.

Përdorimin efektiv të gjuhëve zyrtare në mjediset e punës do ta sigurojnë institucionet komunale, krejt kjo në kuptim të dispozitës së nenit 7 pika 7.5 të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

Aktet plotësuese të miratuara nga institucionet komunale si dhe rregulloret komunale nxirren dhe publikohen në gjuhët zyrtare të komunës.

Versionet në gjuhët zyrtare të akteve nga al. 3 e këtij neni janë të barasvlershme, kjo në kuptim të dispozitës së nenit 7 pika 7.6 të Ligjit për Përdorimin e gjuhëve.

Në rast mospajtimi apo mospërputhshmerie, të verzioneve të përkthyer përparësi ka versioni në gjuhën shqipe.

Neni 7

Emrat zyrtar, shenjat zyrtare në të cilën përfshihen institucionet komunale, organet komunale, fshatrat, rrugët, rrugicat dhe vendet tjera publike paraqitën në gjuhët zyrtare që janë në përdorim zyrtar të komunës sipas nenit 4 al. 2 të kësaj rregullore.

Përdorimi i gjuhëve zyrtare në institucionet arsimore komunale

Neni 8

Çdo person ka të drejtë të regjistrohet si dhe të regjistrojë fëmijët e vetë në shkollën ku gjuha e tij e zgjedhur zyrtare është si gjuhë mësimore në atë institucion (neni 19 pika 19.3 i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve).

Prindi apo personi tjetër që përkujdeset për fëmijët ka të drejtë të zgjedhë gjuhën e vetë të preferuar zyrtare në procesin arsimor (neni 19 pika 19.2. i Ligjit për Përdorimin e gjuhëve).

Neni 9

Në lokalitetet e banuara më persona që i takojnë komuniteteve të ndryshme e në të cilat gjuha amtare e tyre nuk është gjuhë zyrtare personat e atij komuniteti kanë të drejtë të mësojnë në gjuhën e tyre amtare në institucionet publike arsimore në pajtim më udhëzimet administrative të miratuara nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (neni 20 i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve).

MASHT-i me Udhëzim të veçantë përcakton procedurat e deklarimit të për zgjedhjen e gjuhës gjatë shkollimit të mesëm (neni 21 i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve).

Përdorimi i shkrimit në emrat personal

Neni 10

Emri dhe mbiemri i personit i cili kërkon që të bëhet regjistrimi i tij në regjistrat publik si dhe në dokumentet për identifikimin personal dhe në dokumentet e tjera zyrtare në institucionet përkatëse komunale kanë të drejtë në përdorimin e shkrimit dhe gjuhës zyrtare të zgjedhur nga ai person.

Neni 11

Pjesëtarët që i takojnë komuniteteve të tjera gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare në përdorim në komunë do të kenë të drejtën të regjistrojnë emrat dhe mbiemrat e tyre në formën origjinale të tyre në shkrimin dhe në pajtueshmëri me traditat e sistemit linguistik të gjuhës së tyre, një gjë të tillë kanë të drejtë ta bëjnë si në: regjistrat publik, dokumentet për identifikim personal dhe në dokumentet e tjera zyrtare komunale (neni 27 pika 27.2 i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve).

Zbatimi i rregullores

Neni 12

Për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe masat tjera për promovimin e përdorimit dhe statusit të barabartë të gjuhëve zyrtare si dhe për të siguruar mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e gjuhëve të komuniteteve gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare në përdorim sipas kësaj rregulloreje kujdeset Ekzekutivi komunal.

Si stad tjetër lidhur me ruajtjen, promovimin, mbrojtjen dhe sigurimin e statusit të barabartë të gjuhëve është Komisioni i gjuhëve që themelohet nga Qeveria e Kosovës, ndërkaq procedimet tek komisioni i tillë behën në pajtim me dispozitën e nenit 32 të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

Sanksionet administrative në rast të shkeljes së dispozitave të kësaj rregulloreje përcaktohen më Udhëzim të veçantë të Ministrisë së Shërbimeve Publike (neni 33 i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve).

III. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 13

Kjo rregullore shfuqizon çdo dispozitë të rregulloreve të mëparshme komunale të kësaj lëmie, e cila është në kundërshtim me këtë rregullore.

Neni 14


Në rast të zbrazëtirës juridike në tekstin e kësaj rregulloreje drejtë për së drejti vlejné dispozitat e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve të miratuar nga Kuvendi i Kosovës me 27 korrik 2006 dhe nënshkruar nga PSSP me 20 tetor 2006, si dhe dispozitat e akteve të tjera nënligjore të pushtetit qendror.

Neni 15

Rregullorja hynë në fuqi ditën e miratimit të saj nga ana e Kuvendit komunal.

Nr. 01-07-72/07
Klinë, më dt. 27.4.2007.

KUVENDI KOMUNAL KLINË



**Kryetari,
Prenkë Gjetaj**